

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË MINISTRINË E DREJTËSISË

Nr. 1119/10, datë 4.3.2025

Bazuar në nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, nenin 40 e vijues, kreu IX, të vendimit nr. 822, datë 26.12.2024, “Për miratimin e rregullores ‘Për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret Shtetëror’ të NATO-s, të BE-së dhe shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror”, në Ministrinë e Drejtësisë, ngritur me urdhër nr. 51, datë 22.1.2025, të ministrit të Drejtësisë, i mbledhur më datë 13.2.2025, me vendim nr. 16, datë 13.2.2025 të Autoritetit Klasifikues, ka deklasifikuar aktet e klasifikuara të dosjes së urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 620, datë 13.12.2024, “Për vendosjen në regjim të posaçëm të ushtrimit të së drejtave në IEVP të Sigurisë së Lartë” për të dënuarin Fran Marashi, si më poshtë:

a) Deklasifikimin e plotë të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” i përbërë nga:

1. Relacion për vlerësim paraprak nr. 1241 prot., datë 30.10.2024, i Drejtorisë së Çështjeve të Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, Sektori i Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në Fushën Penale, niveli i klasifikimit “Sekret”.

2. Shkresa nr. 1241/1 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

3. Shkresa nr. 1241/2 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

4. Shkresa nr. 1241/3 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

5. Shkresa nr. 1241/4 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

6. Shkresa nr. 1241/5 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për mendim”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

7. Shkresa nr. 1241/6 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

8. Shkresa nr. 1241/7 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

b) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit të Autoritetit Klasifikues, Ministria e Drejtësisë.

MINISTËR I DREJTËSISË

Ulsi Manja